

STATUT DHE AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Keller Williams Victory” shpk

Miratuar në Tiranë, datë 5 Maj 2022

**KREU I
TË PËRGJITHSHME**

Neni 1
Përkufizime

Në këtë Statut dhe Akt Themelimi:

“Ditë të plota” në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

“Ligji” është ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*”, i ndryshuar

“Ortaku” ose “Ortakët” ka kuptimin që i jepet te Neni 2, pika 2.


“Qendra Kombëtare e Biznesit” ose “QKB” ka kuptimin e institucionit sipas ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “*Për regjistrimin e biznesit*”, i ndryshuar, si dhe çdo institucion tjeter që në të ardhmen mund të marrë komptencat e këtij institucioni.

“Statut” është Statuti i shoqërisë Keller Williams Victory

“Shoqëria” ka kuptimin që i jepet në nenin 2 pika 1.

Neni 2
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Në datën 05 Maj 2022, ne themeluesit, kemi krijuar shoqerinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin Keller Williams Victory (në vijim “**Shoqëria**”)
2. Themeluesit e Shoqërisë janë (ku në vijim do t'u referohen së bashku si “Ortakët” dhe veç e veç si “Ortaku”):
 - a. Ermal Beqiri, i biri i Nexhmi-ut, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur datë 23/01/1982 në Gjirokastër dhe banues në Tiranë, identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal I20123025V.
 - b. Flobens Dilaveri, i biri i Dilaver-it, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur datë 18/12/1967 në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal G71218039U.
 - c. Juliana Meçi, e bija e Ton-init shtetase shqiptare, madhere dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur datë 21/04/1980 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me Leternjoftimin me Nr. Personal I05421051R.



d. Priam Ramaj, i biri Arjan-it, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur datë 28/04/1985 në Tiranë dhe banues në Tiranë, identifikuar me Letërnjoftimin me Nr. Personal I50428085I.

Neni 3
Objekti i Veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm: Trajnimë, shitblerje pronash të paluajtshme, studime tregu, akses në sisteme dhe konsulencë në fushën e pasurive të paluajtshme si dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregun e pasurive të paluajtshme.

Neni 4
Kohëzgjatja

Shoqëria do të operojë më kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 5
Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Sami Frashëri", pranë market Baronesha, Kati 2, Ap. 7, Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë.

KREU II
KAPITALI I REGJISTRUAR

Neni 6
Vlera dhe pagesat e Kapitalit të Regjistruar

1. Kapitali themeltar fillestari i Shoqërisë është 10 000 (Dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 4 (katër) kuota.
2. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a. Ortaku themelues: Ermal Beqiri
Lloji i kontributit: Para
Vlera e kontributit: 2 500 (Dymijë e pesëqind) Lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë: 25% (njëzet e pesë për qind)
Numri i kuotave: 1

b. Ortaku themelues: Flobens Dilaveri
Lloji i kontributit: Para
Vlera e kontributit: 3 000 (Tre mijë) Lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë: 30% (tridhjetë për qind)
Numri i kuotave: 1



c. Ortaku themelues: Juliana Meçi
Lloji i kontributit: Para
Vlera e kontributit: 2 000 (Dy mijë) Lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë: 20% (njëzet për qind)
Numri i kuotave: 1

d. Ortaku themelues: Priam Ramaj
Lloji i kontributit: Para
Vlera e kontributit: 2 500 (Dymijë e pesëqind) Lekë
Kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë: 25% (njëzet e pesë për qind)
Numri i kuotave: 1

Neni 7
Llojet e kuotave, të drejtave dhe kufizimeve


Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me vendim unanim të Ortakëve pjesëmarrës, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 8
Certifikatat e Kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzoje cilesinë e letrës me vlerë.

Neni 9
Kalimi me Kontratë i Kuotave

1. Kur një Ortak dëshiron të shesë kuotën e tij plotësisht apo pjesërisht, Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes. Kuota duhet t'i ofrohet së pari Ortakëve të tjerë me të njëjtat kushte që do t'i ofrohej të tretëve.
2. Ortakët e tjerë mund të shfaqin interes për blerjen e kuotës jo më vonë se dy javë pas marrjes së propozimit nga Ortaku që dëshiron të shesë kuotën. Nëse Ortakët nuk shprehen Brenda këtij afati, heshtja do të konsiderohet si refuzim dhe Ortaku do të konsiderohet se e ka respektuar të drejtën e parablerjes.
3. Pas respektimit të të drejtës së parablerjes, Ortaku që dëshiron të shesë kuotën mund të negocjojë me të tretët për të shitur kuotën me kushtet që iu parashtruan Ortakëve të tjerë kur u përmbrush e drejta e parablerjes. Nëse negociatat mes Ortakut dhe personit të interesuar për të blerë kuotën ndryshojnë kushtet e shitjes, e drejta e parablerjes rinovohet.



- Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formalitetave të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Kjo kontratë do të dërgohet në selin e Shoqërisë.
- Nëse Asambleja e Përgjithshme refuzon kalimin e kuotës, Administratorët do të njoftojnë për mospranimin e kalimit të kuotës, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në Shoqëri kërkesa për miratimin e kalimit të kuotës.

Neni 10

Kalimi i Kuotave me Trashëgimi ose si Pasojë e Falimentimit

- Nëse një ortak vdes, trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotëruar ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruarve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria si gjëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e Ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.
- Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një Ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuar nga Administratori, mund të zgjedh të bëhet zotëruar i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej Shoqërisë si përfitues të kuotës.
- Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një Ortaku do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarres ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKB.

Neni 11

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Fillestar

- Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar siç parashikohet në nenin 87 të Ligjit, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të Shoqërisë duke rritur kuotat e Ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e Ortakëve të rinj në Shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me vendim unanim të Ortakëve.
- Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me vendim unanim.

Neni 12

Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e Shoqërisë që do t'u shpërndahen Ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse Shoqëria përbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Adminisitratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta

The image shows three handwritten signatures in blue ink, each preceded by a set of initials. From left to right, the initials are: 'B. B.', 'S.', and 'Q.'. The signatures appear to be official or legal in nature, corresponding to the numbered points in the preceding sections.

nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e Shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.


KREU III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13
Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (e-mail) drejtar çdo Ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përparrë datës së caktuar për mbledhjen përvèç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët unanimisht. Secilit Ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votmin elektronik në mbledhje.
2. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord unanimisht për të marrë vendime, pavarësisht parrëgullësisë në njoftim.

Neni 14
Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumin të parashikuar në këtë Statut dhe nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratori kryeson mbledhjen dhe cakton një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
3. Nëse Administratori nuk dëshitron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse ai nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes Ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishtë shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së



Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

5. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkonet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkonet nga:
 - a. Kryetari;
 - b. një Ortak;
 - c. ose Ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i Ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë Ortaku.
6. Me përjashtim të kundërshtimit të një Ortaku, deklarimi i kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provën përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
7. Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 15
Votat e Ortakëve

1. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep Ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose Ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
2. Në përputhje me nenin 88.1 të Ligjit, asnjë Ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, përsonalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
3. Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do t'i komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të janë të vlefshme.

Neni 16
Votimi me Përfaqësim

1. Përfaqësuesi do të emërohet nga Ortaku nëpërmjet një autorizimi në të cilin do të jetë e përcaktuar data e mbledhjes dhe të dhënat e Përfaqësuesit të Ortakut.

2. Në rastet kur dëshirohet t'u jepet Ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit me autorizim të veçantë nga Ortaku i Përfaqësuar.
3. Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga Shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emëritit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpëra orës së mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 17
Hetimet e Posaçme

Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate notieriale në selinë e Shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.


KREU IV
ADMINISTRIMI

Neni 18
Emërimi i Administratorit

1. Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizik si Administratorë të Shoqërisë për një periudhë pesë vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicë të cilësuar nga Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
2. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorëve parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.
3. Administratori i shoqërisë Keller Williams Victory do të jetë Z. Flobens Dilaveri me një mandat pesë vjecar, duke filluar nga data 05/05/2022 deri në datën 04/05/2027.

Neni 19
Kompetencat e Administratorit

1. Politikat tregtare të Shoqërisë do të administrohen nga Administrator i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e Statutit nga Asambleja e Përgjithshme dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të mblite dhënë.



- Administratori mund t'uua delegojë kompetencat e tyre çdo komitetit i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash kryhet në përputhje me kushtet që vendos Asambleja e Përgjithshme dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegojë detyrimet e tij ligjore.

Neni 20
Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- Personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
- Personi ndodhet në gjendje të paaftësisë paguese;
- Personi vuau ose mund të vuajë nga çregullime mendore;
- Personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërisë, ose
- Ka munguar për më shumë se gjashtë muaj në detyrë pa lejen e Asamblesë së Përgjithshme.


Neni 21
Shpërblimi dhe përfitimet e tjera

- Administratori shpërbilehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme me vendim unanim.
- Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në Shoqëri, Shoqëri të tjera te cilat janë ose kanë qenë Shoqëri të kontrolluara ose për Shoqëri paraardhëse të Shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënier e përfitimeve të tilla.

KREU V
DIVIDENTËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 22
Dividentët

- Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Shoqëria me shumicë të cilësuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të Ortakëve.
- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividentat deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti; në rast se kuota



The image shows three handwritten signatures in blue ink, each enclosed in a large, roughly circular oval. The signatures are positioned below their corresponding numbers (1, 2, and 3) from the list above. The first signature is on the left, the second in the center, and the third on the right. The handwriting is cursive and appears to be in a local language.

emetohen me kushtin e përfitimit të dividentit nga një datë e caktuar, dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3. Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj Shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
4. Cdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë viteve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të cilësuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga Shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 23
Kalimi i fitimeve në kapitalin themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividend preferencial apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të Shoqërisë.

Neni 24
Prishja dhe likuidimi


Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e cilësuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të Ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërdarjes midis Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 25
Njoftimet

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të janë me shkrim ose (nëse zbatohen) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
2. Shoqëria mund të njoftojë një Ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar Shoqërisë nga Ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

Neni 26
Dispozita të fundit

1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e këtij Akt Themelimi e Statuti dhe legjislacionit në fuqi.
2. Shoqëria do të ketë vuoden e saj.




3. Për çdo gjë tjetër që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për Shoqëritë Tregtare, për Qendrën Kombëtare të Biznesit si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimatarinë e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar.
4. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT
E
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Keller Williams Victory shpk

Ermal Beqiri



Flobens Dilaveri

Priam Ramaj

Juliana Meçi



Tiranë, më 05/05/2022

DEKLARATË

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit


Objekti: Deklaratë për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi

Të nderuar,

Në vijim të aplikimit për regjistrimin filletar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Keller Williams Victory” shpk, deklarojmë si ortak themelues të shoqërisë se njohim dhe pranojmë të zbatojmë legjisacionin në fuqi për shoqëritë tregtare, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë: “Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.” Ligji Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligj Nr. 9723, datë 03/05/2007 “Për regjistrimin e Biznesit” dhe çdo akt tjeter ligjor dhe nënligjor në zbatim të ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

DEKLARUES

Ermal Beqiri



Flobens Dilaveri



Priam Ramaj

Juliana Meçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V3022053790234317561

DATE 11/05/2022

NR REP 3588 13

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot me date 11.05.2022 vertetoj nenshkrimin e ortakeve te Shoqerise "Keller Williams Victory" shpk perfaquesuar nga **Ermal Beqiri**, atësia Nexhmi, amësia Nihal, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokaster dhe banues në TIRANË, me adresë Hoxha Tahsin; Nd. 113; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1017; Tiranë, lindur më 23/01/1982, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033711026 dhe nr. personal I20123025V , **Flobens Dilaveri**, atësia Dilaver, amësia Voisav, shtetas Shqiptar, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë Blv. Bajram Curri; Nd. Nd.118; H. Shk 68; Ap. Ap.222; Njësia Administrative Nr. 5, Njesia Bashkiake Nr. 5, 1019; Tiranë, lindur më 18/12/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032194994 dhe nr. personal G71218039U , **Juliana Meçi**, atësia Ton, amësia Hamide, shtetase Shqiptare, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, me adresë S. Frasher P 9/5/45; Nd. Pall.9; H. 5; Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 21/04/1980, gjendja civile "e martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID nr. 032867744 dhe nr. personal I05421051R , **Priam Ramaj**, atësia Arjan, amësia Rita, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Reshit Çollaku; Nd. 38; H. 6; Ap. 36; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 28/04/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035078103 dhe nr. personal I50428085I , te cilet deklaruan se Statuti dhe Akti i Themelimit eshte nenshkruar prej tyre brenda kesaj zyre noteriele dhe une Noterit/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nenshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA DEMOLLARI

*NOTERE
Majlinda E. Demollari
NIP: 2411061704
Tel: 068106170*